

**REZOLUTË 63/155. INTENSIFIKIMI I PËRPPJEKJEVE PËR TË ZHDUKUR TË
GJITHA FORMAT E DHUNËS KUNDËR GRAVE
e adoptuar nga Asambleja e Përgjithëshme**

[mbi raportin e Komitetit të Tretë A/63/425)]

Asambleja e Përgjithëshme,

Duke sjellë në vëmendje rezolutat e veta 61/143 të 19 dhjetor 2006 dhe 62/133 të 18 dhjetor 2007, dhe të gjitha rezolutat e mëparëshme për eliminimin e dhunës kundër grave,

Duke riafirmuar detyrimin e shteteve për të përmirësuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe duke riafirmuar se diskriminimi me bazë seksin bie ndesh me Kartën e Kombeve të Bashkuara, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave¹ dhe instrumente të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe se eliminimi i diskriminimit me bazë seksi është pjesë përbërëse e përpjekjeve për zhdukjen e të gjitha formave të dhunës kundër grave,

Duke riafirmuar po ashtu se Deklarata për Zhdukjen e Dhunës kundër Grave², Deklarata e Beijing dhe Platforma për Veprim³, rezultatet e seancës së posaçme të njëzetë e tre të Asamblesë së Përgjithëshme me titull “Gratë 2000: barazia gjinore, zhvillimi dhe paqja për shekullin e njëzetë e një”⁴, dhe deklarata e adoptuar në seancën e dyzetë e nëntë të Komisionit për Statusin e Grave⁵,

Duke riafirmuar më tej angazhimet ndërkombëtare në fushën e zhvillimit social dhe të barazisë gjinore për përparimin e grave të bërë në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut, Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Takimin e Nivelit të Lartë Botëror për Zhvillimin Social dhe Konferencën Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racial, Ksenofobisë dhe Intolerancës së lidhur me to, si dhe angazhimet e marra në Deklaratën e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara⁶

Dhe Takimi i Nivelit të Lartë Botëror të 2005⁷, dhe duke vërejtur vëmendjen e treguar për Eliminimin e të Gjitha formave të Dhunës kundër Grave Indigjene në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njerëzve Indigjenë e adoptuar nga Asambleja e Përgjithëshme në rezolutën

¹ Kombet e Bashkuara, Seri Traktatesh, vol. 1249, Nr. 20378.

² Shihni rezolutën 48/104.

³ Raporti i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, Beijing, 4–15 shtator 1995 (Publikim i Kombeve të Bashkuara, Shitjet Nr. E.96.IV.13), kap. I, rezoluta 1, anekset i dhe II.

⁴ Rezoluta S-23/2, aneks, dhe rezoluta S-23/3, aneks.

⁵ Lexo Shënimet Zyrtare të Këshillit Ekonomik dhe Social, 2005, Suplementi Nr. 7 dhe ndreqjet e gabimeve (E/2005/27 dhe Corr.1), kap. I, sekt. A; lexoni gjithashtu vendimin e Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror 2005/232.

⁶ Lexoni Rezolutën 55/2

⁷ Lexoni rezolutën 60/1.

61/295 të 13 shtator 2007,

Duke sjellë në vëmendje përfshirjen e krimeve me bazë gjinore dhe krimet e dhunës seksuale në Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Kriminale⁸, si dhe njohja nga tribunalet kriminale ndërkombëtare ad hoc që përdhunimi përbën një krim lufte, një krim kundër njerëzimit ose një akt themelor të gjenocidit ose torturës,

Duke sjellë në vëmendje edhe Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1325 (2000) e 31 tetorit 2000, dhe duke mirëpritur adoptimin e Rezolutës së Këshillit 1820 (2008) e 19 qershorit 2008 për gratë, paqen dhe sigurinë,

Shumë të shqetësuar për përhapjen e dhunës kundër grave dhe vajzave në të gjitha format dhe manifestimet e veta, dhe duke përsëritur nevojën për të intensifikuar përpjekjet për të parandaluar dhe zhdukur të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave në mbarë botën,

Duke kuptuar se dhuna kundër grave i ka rrënjët në marrëdhëniet historikisht të pabarabarta mes burrave dhe grave dhe se të gjitha format e dhunës kundër grave dhunojnë në mënyrë serioze dhe dëmtojnë ose zerojnë gëzimin e të drejtave dhe të lirive themelore, të njeriut, të grave, dhe përbëjnë një pengesë madhore për aftësinë e grave për të përdorur kapacitetet e tyre,

Duke pranuar gjithashtu se varfëria e grave dhe mungesa e pushtetit, që burojnë nga përjashtimi i tyre prej politikave sociale dhe nga përfitimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mund t'i ekspozojnë ato ndaj një rreziku më të madh dhune, dhe se dhuna kundër grave pengon zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të komuniteteve dhe Shteteve, si dhe arritjen e synimeve për zhvillim të pranuar ndërkombëtarisht duke përfshirë Synimet për Zhvillim të Mirëvjeçarit,

Duke pranuar më tej se rritja e autoritetit të grave, duke siguruar përfaqësimin e tyre të plotë dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, është e rëndësishme për eliminimin e dhunës kundër grave dhe vajzave,

Duke pranuar nevojën për të trajtuar çështjen e dhunës kundër grave në tërësinë e vet, përmes kuptimit të lidhjes midis dhunës kundër grave dhe çështjeve të tjera si HIV/AIDS, çrrënjësia e varfërisë, sigurimi i ushqimit, paqja dhe siguria, ndëihma humanitare, shëndeti, dhe parandalimi i krimit,

Duke shprehur vlerësimin e vet për numrin e madh të aktiviteteve të ndërmarra nga Shtetet për të eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave, të tilla si miratimi dhe përmirësimi i legjislacionit që lidhet me aktet e dhunës kundër grave dhe adoptimin e plan-veprimeve kombëtare gjithëpërfshirëse për të luftuar këtë dhunë,

Duke kuptuar rolin e rëndësishëm të shoqërisë civile, në veçanti të organizatave të grave, në përpjekjet për të eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave,

⁸ Kombet e Bashkuara, Seri Traktatesh, vol. 2187, Nr. 38544.

1. *Thekson se* “dhuna kundër grave” nënkupton çdo akt të dhunës me bazë gjinore që rezulton në, ose ka të ngjarë të rezultojë në, dëmtim fizik, seksual ose psikologjik ose vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin me forcë, ose privimin nga liria, qoftë kur kjo ndodh publikisht ose në jetën private;

2. *Të pranohet* që dhuna kundër grave dhe vajzave vazhdon në çdo vend të botës si një dhunim i përhapur i të drejtave të njeriut dhe një pengesë madhore për arritjen e barazisë gjinore, zhvillimit, paqes, dhe qëllimeve të zhvillimit të pranuar ndërkombëtarisht, në veçanti Qëllimet e Mijëvjeçarit për Zhvillim;

3. *Shpreh* shqetësimin e vet për nivelin e mosndëshkimit për akte të dhunës kundër grave në mbarë botën;

4. *Mirëpret* raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për intensifikimin e përpjekjeve për të zhdukur të gjitha format e dhunës kundër grave⁹, dhe konsideron raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për eliminimin e përdhunimit dhe të formave të tjera të dhunës seksuale në të gjitha manifestimet e tij, duke përfshirë në konflikt dhe në situata që lidhen me të¹⁰;

5. *Mirëpret* gjithashtu përpjekjet dhe ndihmesat e rëndësishme në nivelet vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë shkaqet dhe pasojat e tyre, nga Komiteti për Zhdukjen e Diskriminimit kundër Grave dhe Raportuesit të Posaçëm për dhunën kundër grave, në veçanti raportin e dytë tematik për dhunën kundër grave, shkaqet dhe pasojat përgatitur nga Raportuesi i Posaçëm i Këshillit të të Drejtave të Njeriut në 2008¹¹;

6. *Njeh* rolin e rëndësishëm të familjes për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe nevojën për të mbështetur kapacitetin e familjes për të parandaluar dhe luftuar dhunën kundër grave;

7. *Mirëpret* fushatën e Sekretarit të Përgjithshëm për t'i dhënë fund dhunës kundër grave “BASHKOHUNI PËR T’I DHËNË FUND DHUNËS NDAJ GRUAS”, mbështetur, ndër të tjera, nga fushata e Fondit për Zhvillimin e Grave i Kombeve të Bashkuara “Thuaji JO dhunës kundër grave” dhe nisma e agjencive të Kombeve të Bashkuara “Ndal Përdhunimit Tani; Veprimi i Kombeve të Bashkuara kundër Dhunës Seksuale në Konflikt”, thekson nevojën për të garantuar që aktivitete konkrete do të ndërmerren në vazhdim nga sistemi i Kombeve të Bashkuara për të intensifikuar veprimin për ndërprerjen e dhunës kundër grave, në konsultim me aktivitetet ekzistuese të mbarë sistemit për dhunën kundër grave dhe kërkesat e Sekretarit të Përgjithshëm për të identifikuar, shpallur dhe raportuar në bazë të rezultateve të pritshme të fushatës së tij;

8. *Dënon* fuqimisht të gjitha aktet e dhunës kundër grave dhe vajzave, qoftë kur këto akte kryhen nga Shteti, nga persona privatë ose nga aktorë jo shtetërorë, dhe bën thirrje për të

⁹ A/63/214 dhe Korr.1.

¹⁰ A/63/216 dhe Korr.1

¹¹ A/HRC/7/6.

eliminuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në familje, brenda komunitetit në përgjithësi dhe kur shkaktohen ose lejohen nga Shteti;

9. *Thekson* se është e rëndësishme që Shtetet të dënojnë fuqimisht të gjitha format e dhunës kundër grave dhe të mos i referohen ndonjë zakoni tradite apo besimi fetar për t'iu shmangur detyrimeve në lidhje me eliminimin e dhunës si parashtrohet në Deklaratën për Eliminimin e Dhunës Kundër Grave;²

10. *Thekson* gjithashtu se Shtetet kanë detyrimin për të çuar përpara dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të grave dhe të vajzave dhe duhet të ushtrojë vigjilencën e nevojshme për të parandaluar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar autorët e dhunës kundër grave dhe vajzave dhe për t'u dhënë mbrojtje viktimave, dhe se dështimi për të bërë këtë shkel dhe dëmton ose asgjëson gëzimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut;

11. *U bën thirrje* Shteteve që t'i japin fund mosndëshkimit të dhunës kundër grave përmes hetimit, ndjekjes penale dhe ndëshkimit të autorëve duke garantuar që gratë të kenë mbrojtje të njëjtë nga ligji dhe qasje të njëjtë në sistemin e drejtësisë dhe duke tërhequr vëmendjen tek vigjilencën publike duke eliminuar ato qëndrime që ruajnë, justifikojnë ose tolerojnë të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave;

12. *Duke riafirmuar* se vazhdimi i konflikteve të armatosur në pjesë të ndryshme të botës është pengesë madhore për zhdukjen e të gjitha formave të dhunës kundër grave, dhe duke mbajtur në mendje se konfliktet e armatosur dhe tipeve të tjera të konfliktit, dhe terrorizmi, dhe marrja peng vazhdojnë ende në shumë pjesë të botës dhe agresioni, pushtimi i huaj dhe konfliktet etnike dhe format e tjera të konfliktit janë një realitet që vazhdon duke ndikuar gra dhe burra në gati çdo rajon, kërkon nga të gjitha Shtetet dhe nga komuniteti ndërkombëtar që të përqëndrohen veçanërisht dhe t'iu kushtojnë vëmendje parësore dhe ndihmë vuajtjeve të grave dhe vajzave që jetojnë në këto situata dhe për të garantuar që, ku ka dhunë kundër tyre, të gjithë autorët e kësaj dhune të hetohen, dhe ndiqen penalisht dhe të dënohen për t'i dhënë fund mosndëshkimit, ndërsa theksohet nevoja për të respektuar ligjin ndërkombëtar humanitar dhe ligjin për të drejtat e njeriut;

13. *Thekson* nevojën për përjashtimin e vrasjes dhe gjymtimit të grave dhe vajzave, si të ndaluara sipas ligjit ndërkombëtar, dhe krimet e dhunës seksuale nga dispozitat e amnistisë në kontekstin e proceseve të rezolutës së konfliktit;

14. *Thekson* gjithashtu se Shtetet duhet të marrin masa për të garantuar që të gjithë zyrtarët përgjegjës për zbatimin e politikave dhe të programeve që synojnë parandalimin e dhunës kundër grave, mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave, dhe hetimin dhe ndëshkimin e dhunës kundër grave, të marrin trajnimin e duhur për t'i bërë ata të ndjeshëm për nevojat e ndryshme dhe specifike të grave, në veçanti të grave që i janë nënshtruar dhunës, në mënyrë që, gratë të mos riviktimizohen kur kërkojnë drejtësi dhe shpagim;

15. *Thekson* më tej se Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për t'i aftësuar dhe informuar gratë për të drejtat e tyre kur kërkojnë shpagim përmes mekanizmave të drejtësisë, të informojnë të gjithë për të drejtat e grave dhe për ndëshkimet ekzistuese për shkeljet e këtyre të

drejtave, të angazhojnë burrat dhe djemtë, si dhe familjet e tyre, si dhe agjentët ndryshues në parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës ndaj grave;

16. *U bën thirrje* Shteteve që të vazhdojnë të zhvillojnë strategjinë e tyre kombëtare dhe një taktikë më sistematike, gjithëpërfshirëse, shumësektoriale dhe të qëndrueshme që synon në zhdukjen e të gjitha formave të dhunës kundër grave, duke përfshirë arritjen e barazisë gjinore dhe aftësimin e grave, dhe duke përdorur praktikatat më të mira për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe kulturës së tolerancës ndaj dhunës kundër grave, ndër të tjera, në fushat e legjislacionit, parandalimit, zbatimit të ligjit, ndihmës së viktimave dhe rehabilitimit, të tilla si:

(a) *Ngritja* në partneritet me të gjithë grupet e interesit, një plan kombëtar të integruar kushtuar luftës kundër dhunës ndaj grave në të gjitha aspektet e saj, çka përfshin mbledhjen e të dhënave dhe analizën, masat për parandalimin dhe mbrojtjen, si dhe fushatat kombëtare informuese që përdorin burimet për të eliminuar burimet për të eliminuar nga media stereotipe gjinore që çojnë në dhunë kundër grave dhe vajzave;

(b) *Rishikimi* dhe kur është nevoja, përmirësimi ose revokimi i të gjitha ligjeve, rregulloreve, politikave, praktikave dhe zakoneve që diskriminojnë gratë ose kanë ndikim diskriminues mbi gratë, dhe garantimi se dispozitat e sistemeve të shumëfishta ligjore, kur ato ekzistojnë, të përputhen me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, angazhimet dhe parimet, përfshirë parimin e mos-diskriminimit;

(c) *Duke vlerësuar* dhe matur ndikimin e legjislacionit, rregulloreve dhe procedurave aktuale në lidhje me dhunën kundër grave, duke përfshirë edhe arsyet për raportimin e ulët, dhe kur është e nevojshme, përforcimi i ligjit kriminal dhe procedurës që lidhet me të gjitha format e dhunës kundër grave dhe, kur është e nevojshme, përfshirja në ligj e masave që synojnë parandalimin e dhunës kundër grave;

(d) *Duke garantuar* se ka dije të mjaftueshme, përfshirë ekspertizën në taktikat ligjore efektive për eliminimin e dhunës kundër grave, ndërgjegjësimin dhe koordinimin në sistemin ligjor dhe, kur është e përshtatshme, të caktohet një pikë fokale në sistemin ligjor për shkaqet e dhunës kundër grave;

(e) *Duke garantuar* mbledhjen dhe analizën sistematike të të dhënave për të monitoruar të gjitha format e dhunës ndaj grave, ndërsa garantohet dhe ruhet fshehtësia dhe konfidencialiteti i viktimave, duke përfshirë zyrat kombëtare të statistikës dhe kur është e përshtatshme në partneritet me aktorë të tjerë;

(f) *Ngritja* e mekanizmave të përshtatshëm për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave kombëtare, duke përfshirë plan-veprimet kombëtare, të ndërmarra për zhdukjen e dhunës kundër grave dhe vajzave, duke përfshirë përmes përdorimit të indikatorëve kombëtarë;

(g) *Dhënia* e mbështetjes së përshtatshme financiare për zbatimin e plan-veprimeve kombëtare për t'i dhënë fund dhunës kundër grave si dhe aktivitete të tjera të lidhura me të;

(h) *Vënia* në dispozicion e burimeve të përshtatshme për të çuar përpara dhe aftësuar gratë dhe barazinë gjinore dhe për të parandaluar dhe shpërndarë të gjitha format dhe manifestimet e dhunës kundër grave;

(i) *Adoptimi* i të gjitha masave të përshtatshme, veçanërisht në fushën e arsimit, për të modifikuar modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave për të zhdukur paragjykimet, praktikën zakonore dhe praktikën tjetër që bazohen në idenë e inferioritetit ose superioritetit të cilitdo seks dhe në rolet stereotipike për burrat dhe gratë;

(j) *Aftësimi* i grave, në veçanti i grave që jetojnë në varfëri, përmes, ndër të tjera, politikave sociale dhe ekonomike që u garantojnë atyre qasje të plotë dhe të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit dhe në shërbimet e përballeshme dhe të përshtatshme publike dhe sociale, si dhe qasje të barabartë në burimet financiare dhe të drejta të plota dhe të barabarta për të zotëruar truall dhe pasuri të tjera, dhe marrja e masave të përshtatshme për të adresuar numrin në rritje të të pastrehave ose të grave me banesë të papërshtatshme në mënyrë që të pakësohet rreziku për t'u dhunuar;

(k) *Trajtimi* i të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave si vepër kriminale, e dënueshme me ligj, dhe garantimi i dënimeve në përpjestim me shkallën e krimeve dhe të sanksioneve në legjislacionin vendas për të dënuar dhe shpërndarë si duhet, të këqijat e bëra ndaj grave që i janë nënshtruar dhunës;

(l) *Marrja e masave* të efektshme për të parandaluar miratimin e viktimës për t'u bërë pengesë për sjelljen e autorëve të dhunës kundër grave përpara drejtësisë, duke garantuar mbrojtjen e duhur për viktimat;

(m) *Garantimi* që ndihma ligjore e efektshme është në dispozicion të të gjitha femrave viktimat të dhunës në mënyrë që ato të mund të marrin vendime të informuara në lidhje, ndër të tjera, me procedurat dhe çështjet ligjore që lidhen me ligjin e familjes, duke siguruar gjithashtu se viktimat kanë qasje në shpërndarjen e drejtë dhe efektive për dëmet që ato kanë pësuar, duke përfshirë adoptimin e legjislacionit kombëtar kur është e nevojshme;

(n) *Garantimi* që të gjithë zyrtarët publikë përkatës të koordinojnë me efektshmëri parandalimin, hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e të gjitha formave të dhunës dhe ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave;

(o) *Zhvillimi* ose përmirësimi dhe shpërndarja e programeve të specializuara të trajnimit për oficerët e policisë, gjyqësorit, punonjësit shëndetësorë, personelin e zbatimit të ligjit, dhe autoritetet e tjera publike që kanë lidhje, duke përfshirë mjetet praktike dhe praktikën më të mira për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës kundër grave dhe sesi të ndihmohen viktimat e dhunës;

(p) *Forcimi* i infrastrukturës kombëtare shëndetësore dhe sociale për të përforcuar masat për të promovuar qasjen e barabartë të grave në shërbimet publike dhe për të trajtuar pasojat shëndetësore të të gjitha formave të dhunës kundër grave, duke përfshirë mbështetjen e viktimave;

(q)*Ngritja* ose mbështetja e qëndrave të integruara përmes të cilave, u ofrohen strehëza,shërbime ligjore, shëndetësore, psikologjike, këshillimore dhe shërbime të tjera viktimave të dhunës të të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe, kur këto qëndra nuk janë të realizueshme, çuarja përpara e bashkëpunimit dhe koordinimit të agjencive, në mënyrë që t'i bëjnë shpagimet më të arritshme dhe të lehtësojnë riaftësimin fizik, psikologjik, dhe social të viktimave, dhe të garantojnë që viktimat të kenë qasje në këto shërbime;

(r)*Garantimi* i riabilitimit dhe riintegritit të plotë të viktimave të dhunës në shoqëri;

(s)*Garantimi* që sistemi i burgjeve dhe i shërbimeve të lirimit me kusht të ofrojnë programe të përshtatshme rehabilitimi për autorët, si mjete parandaluese për të evituar kthimin në krim;

(t)*Mbështetja* dhe angazhimi në partneritete me organizatat jo-qeveritare, në veçanti me organizatat e grave, dhe aktorë të tjerë që kanë lidhje, dhe sektorin privat për t'i dhënë fund dhunës kundër grave;

17. *i bën thirrje* komunitetit ndërkombëtar, përfshirë sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe, kur duhet, organizatat rajonale dhe nënrajonale për të mbështetur përpjekjet kombëtare për të çuar përpara aftësimin e grave dhe barazinë gjinore në mënyrë që të zgjerohen përpjekjet kombëtare për të zhdukur dhunën kundër grave dhe vajzave, përfshirë, sipas kërkesës, në zhvillimin dhe zbatimin e plan veprimit kombëtar për zhdukjen e dhunës kundër grave dhe vajzave, përmes, ndër të tjera, dhe marrjes në konsideratë të përparësive kombëtare, ndihmës zyrtare për zhvillim, dhe formave të tjera të përshtatshme të ndihmës, të tilla si lehtësimi dhe ndarja e udhëzimeve, metodologjive dhe praktikave më të mira;

18. *Thekson* ndihmesën e tribunalëve ndërkombëtarë penalë për t'i dhënë fund mosndëshkimit përmes garantimit të përcaktimit të përgjegjësisë dhe ndëshkimit të autorëve të dhunës kundër grave, si dhe kontributit që mund të japë Gjykata Kriminale Ndërkombëtare, dhe u kërkon Shteteve që të shohin mundësinë për të ratifikuar ose për t'u bërë palë në Statutin e Romës, që hyrin në fuqi në 1 korrik 2002;

19. *Mirëpret* hapat e marrë nga disa organizma të Kombeve të Bashkuar për të diskutuar brenda mandateve të tyre respektivë, çështjen e dhunës kundër grave në të gjitha format dhe manifestimet e veta, dhe të inkurajojë të gjithë organizmat që kanë lidhje që të vazhdojnë të trajtojnë këtë çështje në përpjekjet e tyre të ardhme dhe në programet e tyre të punës;

20. *Përsërit* kërkesën e vet bërë Rrjetit të Agjencive për Gratë dhe Barazinë Gjinore që të shohë mundësitë dhe mjetet për të zgjeruar efektshmërinë e Fondit të Besimit ët Kombeve të Bashkuara në Mbështetje të Veprimeve për të Zhdukur Dhunën kundër Grave si një mekanizëm financimi për mbarë sistemin për parandalimin dhe shpagimin e të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave, dhe në lidhje me këtë thekson rëndësinë e kontributeve të reja dhe në rritje nga të gjitha Shtetet për Fondin në mënyrë që të arrihet objektivi i caktuar nga Fondi për Zhvillimin e Grave i Kombeve të Bashkuara;

21. *U bën thirrje* të gjithë organeve, njësive, fondeve dhe programeve të Kombeve të Bashkuar, dhe agjencive të specializuara dhe fton institucionet Bretton Woods që të shtojnë përpjekjet e tyre në të gjitha nivelet për të zhdukur të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave dhe për të koordinuar më mirë punën e tyre, ndër të tjera, përmes Task Forcës për Dhunën ndaj Grave të Rrjetit të Agjencive për Gratë dhe Barazinë Gjinore;

22. *i kërkon* Sekretarit të Përgjithshëm që t'i dorëzojë:

(a) Asamblesë së Përgjithshme në sesionin e gjashtëdhjetë e katërt një raport me informacion të dhënë nga organet e Kombeve të Bashkuar, fondet dhe programet e specializuar për aktivitetet në zbatim të rezolutave

61/143 dhe 62/133 të Asamblesë dhe për të paraqitur rezolutë, përfshirë atë për ndihmën e tyre ndaj Shteteve në përpjekjet për të zhdukur të gjitha format e dhunës ndaj grave;

(b) Asamblesë së Përgjithshme në sesionin e vet të gjashtëdhjetë e katërt një raport me informacion të dhënë nga Shtetet për aktivitetet e tyre në zbatim të rezolutës në fjalë;

23. *Kërkon* gjithashtu nga Sekretari i Përgjithshëm që të paraqesë një raport verbal në Komisionin për Statusin e Grave në sesionin e tij të pesëdhjetë e tretë me informacion të dhënë nga organet e Kombeve të Bashkuara, fondet dhe programet e agjencive të specializuara për aktivitetet në zbatim të rezolutave 61/143 dhe 62/133, përfshirë edhe për përparimin e bërë në rritjen e efektshmërisë së Fondit të Besimit të Kombeve të Bashkuara në Mbështetje të Veprimeve për të Zhdukur Dhunën kundër Grave si një mekanizëm i Kombeve të Bashkuara mbarë-sistematik dhe për përparimin e bërë nga fushata e Sekretarit të Përgjithshëm për t'i dhënë fund dhunës kundër grave, dhe i bën thirrje organeve, njësive, fondeve dhe programeve të Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të specializuara që të kontribuojnë menjëherë për këtë raport;

24. *Vendos* që të vazhdojë shqyrtimin e çështjes në sesionin e vet të gjashtëdhjetë e katërt nën titullin "Përparimi i Grave".

Takimi plenar i 70të
18 dhjetor 2008